



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 652/9 prot.

Datë 08.04.2026

**V E N D I M**  
**Nr.483/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.04.2026 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-72781-12-18-2025, me objekt: “Loti 2 “Blerje materiali konsumi të përdorshme me pajisje mjekësore për vlerësimin morfologjik dhe funksional të pllakave Aterosklerotike të Arterieve Koronare””, me fond limit 37,324,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 19.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Health & Light” SHPK me NIPT L42231011L dhe adresë: Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga “Themistokli Gërmenji” Nd. 11, H. 4, Ap.4, Tiranë

Operatori ekonomik “Evita” SHPK me NIPT L31714005J dhe adresë: Rruga Sami Frasheri, Nr.

Pasurie 7/120- N1, Zona Kadastrale 8270, Vol. 28, faqe 155, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a me adresë Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

**Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Health & Light” SHPK me NIPT L42231011L dhe adresë: Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga ”Themistokli Gërmenji” Nd. 11, H. 4, Ap.4, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm

1.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

1.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

1.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

1.6. Ankimesi “Health & Light” SHPK nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 19.12.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-72781-12-18-2025, me objekt: “Loti 2 “Blerje materiali konsumi të përdorshme me pajisje mjekësore për vlerësimin morfologjik dhe funksional të pllakave Aterosklerotike të Arterieve Koronare””, me fond limit 37,324,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 19.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a..

II.2. Në datën 19.01.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt- ankimi.

II.3. Në datën 16.02.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. Health & Light	18,999,750 lekë	Kualifikuar
2. E V I T A	37,315,000 lekë	Kualifikuar

II.4. Në datën 18.02.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Njoftim Fituesi Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Në datën 27.02.2026 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. ankimi elektronik A/2026/6372 dhe me nr. 652/2026 prot, datë 02.03.2026 e operatorit ekonomik “E V I T A” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt,

numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 652/1 prot., datë 03.03.2026 lidhur me pretendimet mbi kualifikimin të operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “Health & Light” SHPK në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike në datën 10.03.2026 ka dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në lidhje me ankimimin e bërë nga ana e operatorit ekonomik “E V I T A” SHPK, argumenta të cilat janë protokolluar me tonën me nr.652/2 prot., datë 10.03.2026.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 4258/15 prot., datë 10.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 652/3 prot., datë 11.03.2026 me objekt “*Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “E V I T A” SHPK...*”, autoritetit kontraktor ka depozituar pranë KPP vendimin e KSHA lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues. Referuar vendimit të KSHA-së, Nr.42/2026, datë 10.03.2026, rezulton se kjo e fundit ka shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj.

II.9. Vendimin e KSHA Nr.42/2026, datë 10.03.2026, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “E V I T A” SHPK, autoriteti kontraktor e ka përcjellë edhe përmes shërimit postar, protokolluar me tonën me nr.652/4 prot., datë 11.03.2026.

II.10. Me shkresën nr. 652/5 prot., datë 12.03.2026, me objekt “*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Evita” SHPK*”, Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar autoritetit kontraktor për dhënien e informacionit si më poshtë: “*...Aktualisht, nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar në KPP informacion për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, por autoriteti kontraktor duhet të dërgojë informacion të hollësishëm mbi hapat e ndjekura nga KVO-ja për trajtimin e ofertës anomalisht të ulët të operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK, si dhe dokumentacionin e plotë të paraqitur nga ky operator ekonomik për të justifikuar ofertën e ekonomike, e cila rezultuon anomalisht e ulët. ..*”.

II.11. Me shkresën nr. 4258/21 prot., datë 17.03.2026, me objekt “*Dërgim dokumentacioni*”, protokolluar me tonën me nr.652/6 prot., datë 19.03.2026, autoriteti kontraktor ka dërguar në Komisionin e Prokurimit Publik informacionin e kërkuar.

II.12. Në datën 06.03.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6398 dhe nr.731/2026 prot, datë 09.03.2026 i operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e ankimit të operatorit ekonomik “Evita” SHPK për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK, nga procedura e

prokurimit të sipërcituar. Në këtë formular ankese janë parashtruar argumentime mbi lënien të kualifikuar të ofertës ekonomike të operatorit ekonomik "Health & Light" SHPK.

II.11. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 "*Për prokurimin Publik*", i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 731/1 prot., datë 09.03.2026.

II.12. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike me shkresën nr. 4258/19 prot., datë 12.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 731/2 prot., datë 13.03.2026 me objekt "*Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "Health & Light" SHPK...*", autoritetit kontraktor ka depozituar pranë KPP vendimin e KSHA lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues. Referuar vendimit të KSHA-së, Nr.47/2026, datë 12.03.2026, rezulton se kjo e fundit ka shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj duke argumentuar : *[...] Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, me anë të postës elektronike zyrtare, më datë 09.03.2026 dërgoi në postën elektronike të deklaruar nga ankimuesi në formularin e ankesës, kërkesën për plotësimin e mangësive të konstatuara lidhur me dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.*

*Plotësimi i këtyre mangësive nuk u korrigjua brenda dy ditëve nga njoftimi.*

*Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas LPP dhe Rregullave të Prokurimit Publik, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin konkret, ankimi administrativ i paraqitur nga OE ankimues nuk mund të konsiderohet si ezaurim i formës së ankimit, pasi mungojnë elementët e domosdoshëm ligjore që duhet të përmbajë një ankimim administrativ, në kontekstin e prokurimit publik.*

*Për sa më sipër, KSHA gjykon se përderisa operatori ekonomik ankimues "Health & Light" shpk nuk ka arritur që brenda afatit 2 ditor, të plotësojë mangësitë e konstatuara lidhur me elementët përmbajtësorë të ankesës, kjo e fundit konsiderohet si e pa paraqitur.*

II.13. Vendimin e KSHA Nr.47/2026, datë 12.03.2026, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues "Health & Light" SHPK, autoriteti kontraktor e ka përcjellë edhe përmes shërimit postar, protokolluar me tonën me nr.731/3 prot., datë 17.03.2026.

II.14. Me qëllim vijim e shqyrtimit të mëtejshëm të ankesës nga KPP me shkresën nr.731/4 prot., datë 24.03.2026 ju kërkua informacion Sektorit të Financës mbi statusin aktual të pagesës për ankesën objekt shqyrtimi.

II.15 Me shkresën nr 731/5 prot., datë 26.03.2026, lidhur me kërkesën e bërë për statusin e ankesës së operatorit ekonomik "Health & Light" SHPK, Sekori i Financës informon se: "*[...] Referuar raportit të dërguar më datë 25.03.2026 nga Dega e Thesarit për arkëtimet e kryera*

deri më datë 19.03.2026, rezulton se operatori ekonomik ”“Health & Light” SHPK nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar”.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

#### Arsyeton:

III.1 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “E V I T A” SHPK”, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së parqaitur nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK me arsyen se, pajisjet e ofruar nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK), nuk plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara e më konkretisht specifikimin “*Kateter intravaskular me fibër optike me veshje hidrofile*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.3.7 “*Kapaciteti teknik*”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

*7.Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë / skeda teknike për artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara. Në katalogët / skedat teknike të paraqitura, duhet të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), specifikimet teknike sipas DST. (Katalogët / skedat teknike duhet të ngarkohen në [ëëë.app.gov.al](http://ëëë.app.gov.al) së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT).*

Ndërsa në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, të dokumenteve të tenderit është përcaktuar:

#### Specifikimet Teknike

#### LOT 2: “BLERJE MATERIALI KONSUMI TË PËRDORSHME ME PAJISJE MJEKËSORE PËR VLERËSIMIN MORFOLOGJIK DHE FUNKSIONAL TË PLLAKAVE ATEROSKLEROTIKE TË ARTERIEVE KORONARE”

Nr.	Produkti
1	Kateter intravaskular me fibër optike për imazheri me OCT
2	Qese sterile për kateterët e OCT

**Specifikimet Teknike të Përgjithshme:**

- Operatori Ekonomik duhet të jetë e certifikuar me ISO 9001: 2015 ose **ISO 13485:2016**, të vlefshme.
- Operatori Ekonomik duhet të jetë e autorizuar nga Ministria e Shëndetësisë për tregëtim të pajisjeve mjekësore.

**Specifikimet Teknike të Veçanta:**

- Specifikimet teknike të pajisjeve janë specifikimet minimale që duhet të plotësojnë këto pajisje. Janë të mirëpritura pajisje me specifikime më të mira.
- Të gjitha pajisjet dhe softëare përkatës duhet të jenë të certifikuara CE ose FDA
- Të gjitha pajisjet e mëposhtme mjekësore, pjesët përbërëse dhe aksesoret e tyre duhet të jenë të reja, të prodhuara jo më shumë se 1 (një) vit më parë
- Të gjithë pajisjet duhet të shoqërohen me të gjithë informacionin e nevojshëm si broshura, manuale përdorimi, manual teknikë, etj
- Për të gjitha pajisjet duhet të kryhen trajnimet përkatëse për përdorimin e tyre.
- Garancia e pajisjeve të jetë jo më pak se 1(një) vit

**1. Kateter intravaskular me fibër optike për imazheri me OCT**

- Kateter intravaskular me fibër optike osciluese për imazheri me OCT, kompatibël me minimum 5F Guiding Catheter, me shkëmbim të shpejtë, gjatësi minimale 130 cm, diametër i jashtëm më pak se 2.8F distal, shënues (marker) për vizualizim të gjatësisë, veshje hidrofile, e pajtueshme me një gidë angioplastike standarde 0.014”.
- Të ketë rezolucion të lartë të imazhit të përfituar (15 mikron ose më pak).
- Të ketë shpejtësi të lartë të skanimit longitudinal të lezionit (> 20 mm/s).
- Të ketë provën e përdorimit të mëparshëm në Kabinete Hemodinamike në shtetet e EU dhe / ose USA (jo materiale eksperimentale ose në testim).

**2. Qese sterile për kateterët e OCT**

- Qese sterile për mbulimin e modulit që lidh kateterët e OCT me pajisjen.
- Të përshtatshme për kateterët dhe aparatit e OCT.

**3. Tel për matjen e FFR dhe RFR**

- Tel për matjen e Fractional Floë Reserve / FFR dhe Resting Full-Cycle Ratio / RFR duke përdorur teknologjinë pa tel (ëireless).

- Të ofrohen dy gjatësi standarde, 170 cm – 180 cm dhe 280 cm – 320 cm.
- Të ketë veshje hidrofille, majë standarde radio-opake, gjatësia e zonës radio-opake 25 – 35 mm.
- Të ketë diapazon të lartë ndjeshmërie (nga -30 mmHg në + 300 mmHg) / devijim i ulët i presionit ( $\leq 2$  mmHg ose 2%).
- Të ketë jetëgjatësi të lartë të baterisë (>2.5 orë).

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Health & Light” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Shtojca 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” ku operatori ekonomik ka plotësuar Pjesën III “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit” A: Deklaratë “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”.
- Dokumentin me emërtimin “ P80-E\_Product\_Catalogue-1\_Loti\_1-2”,
- P80-E\_Technical\_Specifications-0816\_Loti\_1-2

III.1.3. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

[...]

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.*

III.1.4. Në nenin 40 pika 6 germa b) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:  
b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose [...]

III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “E V I T A “ SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK me arsyen se, pajisjet e ofruara nga operatori ekonomik OE “Health & Light” SHPK, nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara e më konkretisht specifikimin *Kateter intravaskular me fibër optike me veshje hidrofille*, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, KPP vëren se, autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, ka përcaktuar specifikimet teknike të cilat duhet të përmbushin produktet objekt prokurimi. Konkretisht për pajisjen objekt prokurimi “1.Kateter intravaskular me fibër optike për imazheri me OCT”, ndër specifikimet e kërkuara është edhe specifikimi teknik *“veshje hidrofille*.. Gjithashtu, në “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.7 e “Kapacitetit teknik”, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik të paraqesë katalogë teknikë / skeda teknike për artikujt e ofertuar, ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara. KPP konstaton se, qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet katalogëve të kërkuar, të verifikohen specifikimet teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë, për të parë përputhshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për këto artikuj.

Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK, konstaton se, ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka paraqitur dokumentacionin e përmendur në pikën III.1.2 të këtij vendimi, Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike si dhe katalogun e produktit të ofruar, ku janë markuar specifikimet teknike për pajisjet e kërkuara

Lidhur me pretendimin e ankimuesit se pajisja “Kateter intravaskular me fibër optike për imazheri me OCT” e ofruar nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK nuk përmbush specifikimin e kërkuar, *veshje hidrofille*, Komisioni konstaton se, për pajisjen objekt prokurimi

“Kateter intravaskular me fibër optike për imazheri me OCT”, operatori ekonomik “Health & Light” SHPK ka dorëzuar katalogun e kompanisë “Vivolight”, ku evidentohet se pajisja përmbush specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit. Sa i përket specifikimit teknik *veshje hidrofile*, pavarësisht se në katalog nuk evidentohet ky specifikim teknik, referuar deklaratës së prodhuesit Vivolight, të cilën operatori ekonomik “Health & Light” SHPK e ka dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik në momentin e ofertimit, evidentohet se pajisja e ofruar është me veshje hidrofile, sikurse përcaktohet në dokumentat e tenderit. Komisioni vlerëson të evidentojë faktin se jo cdo specifikim teknik i kërkuar nga autoriteti kontraktore është i përfshirë në katalogët e pajisjeve që prodhuesi publikon. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se pajisja e ofruar nga operatori ekonomik përmbush specifikimin teknik veshje hidrofile për Kateter intravaskular me fibër optike për imazheri me OCT, të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues se pajisja *Tel për matjen e FFR dhe RFR nuk përdor teknologji ëireless (pa tel)*, sikurse kërkohet në dokumentat e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, ka përcaktuar specifikimet teknike të cilat duhet të përmbushin produktet objekt prokurimi. Konkretisht për pajisjen objekt prokurimi “Tel për matjen e FFR dhe RFR”, ndër specifikimet e kërkuara është edhe specifikimi teknik “Tel për matjen e Fractional Floë Reserve / FFR dhe Resting Full-Cycle Ratio / RFR duke përdorur teknologjinë pa tel (ëireless). Gjithashtu në dokumentat e tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar *Janë të mirëpritura pajisje me specifikime më të mira*. Komisioni konstaton se, për pajisjen objekt prokurimi operatori ekonomik “Health & Light” SHPK ka dorëzuar katalogun e kompanisë “Vivolight”, ku evidentohet se kjo kompani nuk përdor ëire based FFR por përdor OCT –FFR technology nëpërmjet softëare. Qëllimi funksional i pajisjes së kërkuar është matje të FFR (Fractional Floë Reserve). Në dokumentat e tenderit është specifikuar teknologjia e matjes *teknologji ëireless (pa tel)*, por është përcaktuar gjithashtu se janë të mirëpritura pajisje me specifikime më të mira. Kompania Vivolight përdor OCT-FFR bazuar në softëare duke përmbushur funksionin e pajisjes, që është të japë vlerësim të saktë të presionit dhe rrjedhjes së gjakut në arteriet koronare. Komisioni vlerëson se, pajisja e ofruar nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK plotëson funksionin e kërkuar jo përmes teknologjisë ëireless, por përmes një teknologjie më të avancuar sikurse autoriteti kontraktor vet ka specifikuar/përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni, gjykon se operatori ekonomik “Health & Light” SHPK, me dokumentacionin e dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik plotëson kriterin 2.3.7 të kriterëve të vecanta të kualifikimit për kualifikim në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK me arsyetimin si vijon: “4. *Verifikim të integritetit të plotë në kabinetin ekzistues të hemodinamikës.*”, Komisioni i Prokurimit Publik

gjykon, se në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe KPP, për këto pretendime, operatori ekonomik ankimues, nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime a-priori, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me mosplotësimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.7 të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

III.2.1. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3: - *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni*”.

III.2.2. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij për mospërmbushjen nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK të kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.7 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, ankimuesi “E V I T A “ SHPK duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej ky pretendim. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.2.3. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë, se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kriterëve nga ana e operatorëve të tjerë ekonomikë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin, etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë, në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.2.5. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimuesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe në kuptim të misionit të tij për të siguruar efiçencën e procedurave të prokurimit publik, përmes

nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim proaktiv, në krahasim të operatorit ankimues. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, peshat specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plota provuese, se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtojnë pretendime a-priori duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij. Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se “*Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”. Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “*onus probandi incumbit actori*” se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjitha elementet procedurale, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.2.6. Një pretendim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementeve përbërëse të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar para tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik është parë nga ligji si një quasi gjykatë. Si e tillë në vendimmarrjen e saj, KPP zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një pretendim, i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme. Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “E V I T A “ SHPK, për mospërmbushjen nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK të kriterit të përcaktuar në pikën 6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, nuk merret në shqyrtim.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK me arsyetimin si vijon: “*...oferta e operatorit ekonomik të renditur i pari është oferte anomalisht e ulët*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë KPP-së, me shkresën nr.4258/21 prot., datë 17.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 652/6 prot., datë 19.03.2026,

rezulton se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët ka konstatuar, se oferta e operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK është në kushtet e ofertës anomalisht të ulët. Në këto kushte KVO i është drejtuar operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK me kërkesë që brenda 3 ditëve pune, të paraqesë pranë autoritetit shpjegime, në lidhje me ofertën anomalisht të ulët, të cilat duhet t'i argumentonte dhe dokumentonte edhe me prova shkresore.

III.3.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë KPP-së me shkresën nr.4258/21 prot., datë 17.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 652/6 prot., datë 19.03.2026m rezulton, se në përgjigje të kërkesës së autoritetit kontraktor më datë 12.02.2026, operatori ekonomik “Health & Light” SHPK, ka depozituar në autoritetin kontraktor dokumentin me objekt “*Kthim përgjigje shkresës datë 09.02.2026. Kërkesë mbi ofertën anomalisht të ulët*”, shoqëruar me: Ofertën e marrë nga prodhuesi i artikujve te lotit 2, Deklaratën e prodhuesit për teknologjinë Oct-FFr, Studimin mbi diskrepancën midid FFR dhe RFR, Cerifikatë Iso 14001-2015, Cerifikatë Iso 45001-2018.

III.3.3. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*”i ndryshuar, përcaktohet se: “*1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.*

*2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:*

*a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;*

*b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;*

*c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;*

*ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;*

*d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.*

*3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [...].”*

III.3.4. Në nenin 82 “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”i ndryshuar, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

*Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:*  
*- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;*

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPPsë, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPPsë.

- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.3.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK me arsyen se ka paraqitur një ofertë anomalisht të ulët, nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se oferta ekonomike në vlerën prej 18,999,750 lekë pa TVSH, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të *lex specialis*. Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP gjykon, se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për t’i dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë mundësinë e tyre për të përfutur

ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së, autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. KPP gjykon, se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e furnizimit/shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP thekson se referuar nenit 2 gërma “b” “*Qëllimi*” i ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, parashikohet se; “*Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale*”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërkimit të operatorit ekonomik ankimes, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe mundësinë për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.3.6. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK, në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton, se argumentimi i dhënë prej tij është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik lidhur me argumentimin/sqarimin e ofertës anomalisht të ulët.

Konkretisht, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “S Health & Light” SHPK, ka paraqitur si dokumentacion mbështetës/ provues: argumentimin e ofertës në mënyrë narrative përmes shkresës datë 12.02.2026 me lëndë “*Kthim përgjigje...*”, ku ka shpjeguar të gjitha elementet e ofertës së paraqitur prej tij dhe duke e justifikuar çmimin e ofertuar bazuar në disa komponentë. Konkretisht ankimesi ka deklaruar se:

Sa i përket anës ekonomike të procesit të prodhimit shoqëria “Health & Light” SHPK ka hartuar ofertën e tij bazuar në ofertën e marrë drejtpërdrejtë nga prodhuesi, ku evidentohet se kosto e blerjes së artikujve object prokurimi është në vlerën 8,028,150 lekë, ndërsa vlera e ofertuar 18,999,750 lekë. Gjithashtu oferuesi ka dhënë shpjegime edhe sa i përket zgjidhjes teknike të përzgjedhur, origjinalitetit të furnizimeve të propozuara , si dhe pajtueshmërisë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës. Përveç argumentimit në formën e një narrative, ku shpjegon çmimin e ofertuar prej tij dhe elementet

favorizuese që disponon, operatori ekonomik “Health & Light” SHPK ka paraqitur edhe ofertën e marrë nga prodhuesi për të justifikuar cmimin e ofertuar për mallrat objekt prokurimi Pra, operatori ekonomik ankimues ka arritur që të argumentojë ofertën anomalisht të ulët, duke krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Rrjedhimisht Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK, është paraqitur argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në përputhje me nenin 93 pika 2 të LPP-së.

III.3.7. Komisioni gjykon, se një ofertë anomalisht e ulët mund të justifikohet ekonomikisht përmes metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushteve përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK janë dorëzuar të gjitha dokumentet provuese mbi metodën e ndërtimit të ofertës ekonomike, mbi të cilën edhe operatori ekonomik ka ofertuar në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe ose ndonjë kusht favorizues, origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, duke argumentuar plotësisht, se pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Argumentimi i dhënë nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK., në rastin konkret krijon bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Akoma më tej, Komisioni sjell në vëmendje faktin, se është detyrim i operatorëve ekonomikë, që në rast të shpalljes fitues, t’i përmbahen zbatimit të kontratës duke ofruar shërbime/punë/mallra me të njëjtën cilësi, të kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe me të njëjtën ofertë ekonomike të propozuar. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të detyrimeve që rrjedhin nga LPP, për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit/punës/shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet sipas parashikimeve të *lex specialis* për prokurimin publik.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, nuk qëndron.

III.4. Lidhur me ankesën e administruar në datën 06.03.2026 me nr. A/2026/6398 dhe nr.731/2026 prot, datë 09.03.2026, të operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-72781-12-18-2025, me objekt: “Loti 2 “Blerje materiali konsumi të përdorshme me pajisje mjekësore për vlerësimin morfologjik dhe funksional të pllakave Aterosklerotike të Arterieve Koronare””, me fond limit 37,324,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 19.01.2026 nga autoriteti kontraktor,

Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, mbi kundërshtimin e ankimit të operatorit ekonomik “Evita” SHPK për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka kryer pagesën e tarifës financiare për ankesën e mësipërme, në përputhje me përcaktimet në nenin 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se:

*“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.*

*2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështetin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t’i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.*

*3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.*

*4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”*

III.4.1. Në gjermën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është parashikuar se: *“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.*

III.4.2. Autoriteti kontraktor me shkresën nr.4258/19., datë 12.03.2026, me objekt *“Mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK”*, protokolluar me tonën me nr.731/2 prot., datë 13.03.2026 ka përcjellë vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues. Referuar vendimit të KSHA-së, Nr.47/2026, datë 12.03.2026, rezulton se kjo e fundit ka shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e ankesës së ankimesit si të paparaqitur, për shkak të moskorrigjimit të të metave të ankesës nga operatori ekonomik ankimues.

III.4.3. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e

tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t'i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar në KPP, vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave Nr.47/2026, datë 12.03.2026, lidhur me ankesën e operatorit ankimes “Health & Light” SHPK, rezulton, se autoriteti kontraktor ka zbatuar përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, duke respektuar hapat proceduralë që parashikon kjo dispozitë ligjore, sepse përmes postës elektronike më datë 09.03.2026, autoriteti kontraktor i ka kërkuar operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK, ndreqjen e të metave të ankesës, në rastin konkret kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën e paraqitur.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni Prokurimit Publik, konstaton se autoriteti kontraktor ka njoftuar (më datë 09.03.2026) operatorin ekonomik ankimes “Health & Light” SHPK përmes *postës elektronike*, në lidhje me korrigjimin e mangësive të konstatuara në lidhje me elementet formale të ankesës, konkretisht pagesës së tarifës së ankesës. Gjithashtu me shkresën nr.7315 prot., datë 26.03.2026, lidhur me kërkesën e bërë për statusin e ankesës së operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK, Sekori i Financës informon se: “informon se: “[...] Referuar raportit të dërguar më datë 25.03.2026 nga Dega e Thesarit për arkëtimet e kryera deri më datë 19.03.2026, rezulton se operatori ekonomik ”“Health & Light” SHPK nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar”.

Sa më sipër, konstatohet se ankimesi nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës në përputhje më përcaktimet e pikës 2 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar duke mos plotësuar kështu një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës.

Sa më sipër argumentuar, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se, për sa kohë ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues nuk plotëson kushtet formale, siç është pagesa e tarifës, duhet refuzuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Evita” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-72781-12-18-2025, me objekt: “Loti 2 “Blerje materiali konsumi të përdorshme me pajisje mjekësore për vlerësimin morfologjik dhe funksional të pllakave Aterosklerotike të Arterieve Koronare”, me fond limit 37,324,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 19.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
  2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit
  3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërpërmendur
  4. Ngarkohet zyra e financës të kryej veprimet përkatëse për dedhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Evita” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

